PSAT/NMSQT®

CollegeBoard / NATIONAL MERIT SCHOLARSHIP CORPORATION

Fall 2026

PSAT/NMSQT

Paper Test Directions

Translated into Albanian for Students

Notes to the Proctor

Using this document on test day:

Distribute this document once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book. Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period. Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

IMPORTANT: Students must not sign in to Bluebook on test day for any reason, including section timing. All timing MUST be administered by the proctor using the Paper Testing Script. Use of Bluebook will cause a misadministration and require a retest.

Shënime për nxënësin

Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që kujdestari juaj do t'i lexojë me zë, si dhe udhëzimeve të shkruara që gjenden në librat e testit tuaj. Përcillni udhëzimet derisa kujdestari juaj i lexon ato me zë në anglisht. Nëse keni pyetje rreth asaj se çfarë është duke lexuar kujdestari juaj, ju lutem ngrisni dorën.

- Këto udhëzime të përkthyera mund të mos përshtaten fjalë për fjalë me atë që lexon kujdestari juaj; megjithatë informatat e rëndësishme janë të njëjta.
- Kujdestari juaj mund të kapërcejë disa udhëzime që nuk vlejnë për situatën tuaj të testimit.
- Mund ta mbani këtë dokument në tavolinë gjatë gjithë kohës së testimit por duhet t'ia ktheni kujdestarit tuaj pas testimit.
- MOS e përdorni këtë dokument për letër skrapi.
- Në kohë të ndryshme, kujdestari juaj do të lajmërojë sa është koha e mbetur për pjesën, si dhe për pauzat kur të jetë e përshtatshme. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, këto lajmërime mund të dallojnë sa i përket kohës dhe pauzave të listuara në këtë dokument të përkthyer. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj.
- Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, kujdestari i juaj mund të ju jep udhëzime shtesë në gjuhën angleze.
- Ikonat përdoren përgjatë tërë këtij dokumenti për të ju tërhequr vëmendjen në informata specifike:

Informatë e rëndësishme

Udhëzimet që përmban libri juaj i testimit

I gjithë teksti i hijezuar tregon udhëzimet e thëna nga kujdestari juaj.

Lidhur me National Merit Scholarship Corporation (NMSC)

National Merit Scholarship Corporation (NMSC®) është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse që vepron pa ndihmë qeveritare. NMSC realizon Programin e bursave National Merit® Scholarship Program, një konkurrim akademik vjetor për njohje dhe bursa universitare.

Testi preliminar Preliminary SAT/National Merit Scholarship Qualifying Test (PSAT/NMSQT®), e cila bashkësponsorizohet nga College Board dhe NMSC, është rruga për të hyrë në National Merit Scholarship Program. Nëse ju keni pyetje në lidhje me ndonjë aspekt të National Merit Scholarship Program, duke përfshirë kërkesat për pjesëmarrjen e nxënëseve, procesin e përzgjedhjes dhe bursat e ofruara, vizitoni **www.nationalmerit.org**.

Përmbajtja

1 **Notes to the Proctor**
2 **Shënime për nxënësin**
3 **Lidhur me National Merit Scholarship Corporation (NMSC)**
5 **Mirë se vini**
6 **Udhëzime për Studentët me Mjete ndihmëse të Caktuara**
7 **Përgatituni për Testin**
9 Udhëzimet në kopertinën e pasme
10 **Moduli 1: Lexim dhe Shkrim**
10 Udhëzime për Modulin 1 të Leximit dhe Shkrimit
11 Për nxënësit që testohen me Pushime Shtesë ose Kohë të Zgjatur
12 **Moduli 2: Lexim dhe Shkrim**
12 Udhëzime për Modulin 2 të Leximit dhe Shkrimit
13 **Ndarja e Seksionit**
14 **Moduli 1: Matematikë**
14 Udhëzimet e Modulit 1 të Matematikës
16 Për nxënësit që testohen me Pushime Shtesë ose Kohë të Zgjatur
17 **Moduli 2: Matematikë**
17 Udhëzimet e Modulit 2 të Matematikës
19 **Lirimi**

2 Mirë se vini

Mirë se vini. Sot po hyni në testin Preliminary SAT/National Merit Scholarship, i njohur edhe si PSAT/NMSQT, i cili përqendrohet në atë që po mësoni tani. Është gjithashtu një shans për të ushtruar për SAT dhe për t'u kualifikuar për programet e bursave.

Para se të filloni testin, unë do ti lexoj disa udhëzime dhe do t'ju shpërndaj disa broshura me informata që t'i rishikoni dhe plotësoni. Përveç kësaj, do t'ju jap çdo material në lidhje me mjetet tuaja ndihmëse. Dhe nëse keni sjellë një kalkulator, unë do të sigurohem që është i pranueshëm.

Ju lutem dëgjoni me kujdes këto udhëzime.

Nëse keni telefona, orë të mençur, syze të mençur ose pajisje të tjera të ndaluara, fikini ato dhe ti vendos ato nën bankën tuaj tani.

Në bankën tuaj, duhet të keni biletë tuaj të pranimit, lapsat dhe çdo mjet ndihmës testimi që është miratuar ta përdorni si mjet ndihmës. Nëse i keni sjellë, vendosni kalkulatorin tuaj të pranueshëm dhe kalkulatorin rezervë nën bankën tuaj. Sigurohuni që të fshini të gjitha formulat e ruajtura nga kalkulatori juaj. Do të të njoftoj kur mund ta përdorësh kalkulatorin tënd.

Nëse keni sjellë me vete ndonjë ushqim të lehtë, pije, mbulesë llogaritëse ose ndonjë mjet pastrimi si dezinfektues duarsh, ju lutemi vendosini këto artikuj nën bankën tuaj. Ju lutem hiqni çdo send tjetër nga banka juaj dhe vendosini në çantat tuaja në pjesën e përparme ose anësore të klasës.

Duhet të keni gjithashtu 1 fletë letre për ushtrime, të cilën do ta marr pas testit, kështu që mos e grisni. Shkruani emrin tuaj të plotë në këndin e sipërm të djathtë. Nëse nuk keni ende një fletë letre për ushtrime, më njoftoni kur të jem te banka juaj. Tani do të eci nëpër dhomë për të konfirmuar që tavolinat tuaja janë të pastruara dhe gati për testim.

3 Udhëzime për Studentët me Mjete ndihmëse të Caktuara

Kujdestari juaj mund t'ju lexojë udhëzime në vijim për ju ose personelin mbështetës. Përndryshe, ata do të kalojnë përpara te Përgatitu për Testim.

Për nxënësit që testohen me teknologji ndihmëse, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse jeni duke përdorur një teknologji ndihmëse të miratuar, tani është koha për t'u siguruar që po funksionon. Nëse i keni personalizuar cilësimet tuaja gjatë ushtrimeve, mund t'ju duhet ta përsërisni këtë hap tani. Mbani në mend, mund të përdorni veçoritë e integruara në pajisjen tuaj.

Për nxënësit që testohen me një lexues njerëzor, kujdestari juaj do të thotë:

Lexuesit duhet t'i lexojnë pyetjet me zë të lartë aq shpesh sa kërkohet. Është e rëndësishme që ata të lexojnë saktësisht vetëm atë që është në skript. Ata nuk duhet të shpjegojnë, edhe nëse e kërkoni këtë nga ata.

Për nxënësit që testohen me një shkrues, kujdestari juaj do të thotë:

Shkruesit duhet të shkruajnë vetëm përgjigjet dhe korrigjimet që ju i diktoni. Ata nuk mund t'ju japin ndihmë në mënyrë që do të rezultonte në një përgjigje të ndryshme. Shkruesit do t'u lexojnë përgjigjet tuaja prapa nëse doni të rishikoni punën tuaj.

Për nxënësit që testohen me një format braille, kujdestari juaj do të thotë:

Testi braille është i ndarë në disa libra. Do t'ju jepet 1 libër në të njëjtën kohë. Gjatë gjithë testit, çdo pyetje ndahet nga një tjetër me një vijë. Çdo pyetje fillon në celulën 1, me shënimet (runovers) që fillojnë në qelizën 5. Çdo zgjedhje e përgjigjes fillon në celulën 3, me shënimet (runovers) që fillojnë në celulën 5.

Braille është në Unified English Braille (UEB). Seksionet e Matematikës janë në Nemeth Code përveç nëse keni leje për testimin me Dokumentin Braille UEB with Technical Math (UEB me Matematikë Teknike). Libri i referencës së matematikës braille përmban formula dhe udhëzime matematikore për përdorim me të gjitha seksionet e matematikës. Testi juaj përfshin vizatime me vijë të ngritur të grafikëve dhe figurave të përdorura në test.

4 Përgatituni për Testin

Seksioni i Leximit dhe i Shkrimit dhe seksioni i Matematikës përmbajnë secili nga dy module, të matura veçmas me kohë. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndaljes për çdo modul me kohë këtu *[kujdestari juaj do të tregojë se ku do të postohet ky informacion]*, dhe do të njoftoj kur të mbeten 5 minuta në secilin modul.

Unë do të ec nëpër klasë kohë pas kohe për t'u siguruar se të gjithë janë duke punuar në modulin e saktë. Për këtë test, ju mund të punoni vetëm në një modul në të njëjtën kohë. Kjo mund të jetë ndryshe nga sa jeni mësuar, kështu që sigurohuni të mos ecni përpara ose të mos shikoni prapa në librin e testit edhe nëse e përfundoni modulin e tanishëm.

Pasi të përfundojë testi, ju lutem qëndroni ulur dhe mos u largoni nga klasa derisa të ju liroj. Nëse keni ndonjë pyetje përfundimtare mund ta bëni tani. Nëse keni nevojë për ndihmë apo letër shtesë për shënime në çdo kohë, ngrini dorën dhe unë do të vij. Mos harroni të shkruani emrin tuaj të plotë në letër shtesë për shënime. A ka dikush ndonjë pyetje?

Tani do t'jua jap librat tuaj të testit. Mos e hapni akoma.

Shihni përkthimin e kopertinës së pasme të librit të provimit, që vijon këtë seksion.

Kthehuni në pjesën e pasme të librit tuaj të testimit dhe shënoni mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni një të tillë. Mund ta gjeni emrin e shkollës, kodin e shkollës së College Board, si dhe numrin e klasës sonë të shkruar në tabelë. Kur të keni përfunduar me këtë hap, ju lutem leni poshtë lapsin tuaj dhe shikoni lart nga unë.

Tani do t'ju shpërndaj nga një kopje të *Paper Test Taker Administration Instructions* për secilin prej jush.

Testi që do të hyni është në format letre të testit digjital PSAT/NMSQT. Kur nxënësit përfundojnë cilësimet e provimit në Bluebook, aplikacionin e testimit digjital, ata shohin dhe u përgjigjen informatave të rëndësishme. Broshurën që sapo e dhashë përmban atë informatë.

Hapni broshurën tuaj në faqen 3 dhe lexoni te pjesa **Student Starts Here (Studenti Fillon Këtu)**. Ndiqni udhëzimet, të cilat përfshijnë plotësimin e disa informatave në kopertinën e përparmë. Mund ta gjeni numrin tuaj të regjistrimit në biletën tuaj të hyrjes. Ngrini dorën nëse keni nevojë për ndihmë për të gjetur ndonjë nga informacionet e kërkuara. Kur të keni përfunduar, leni poshtë lapsin tuaj dhe shikoni lart nga unë.

Tani do ta lexoni dhe plotësoni pjesën tjetër të *Paper Test Taker Administration Instructions*. Është e rëndësishme të lexoni me kujdes të gjithë dokumentin. Së pari, do të lexoni pjesë rreth këtyre udhëzimeve dhe cilat informata do t'ju kërkoj t'i plotësoni. Pastaj ju do të lexoni një pjesë të quajtur **Use of the Bluebook App (Përdorimi i Aplikacionit Bluebook)**. Ky seksion shpjegon se si do të

transkriptohen përgjigjet tuaja nga libri i testit në aplikacionin Bluebook. Kur të keni mbaruar së lexuari dhe të keni shënuar kutinë në fund të seksionit për të treguar se jeni dakord me këto politika, uleni lapsin dhe shikoni lart nga unë.

Pastaj, do ti keni rreth 15 minuta për të lexuar dhe pranuar rregullat e testimit për këtë provim. Unë do të përjashtoj këdo që përpiqet të thyejë rregullat dhe rezultatet e tyre do të anulohen. Atyre gjithashtu mund t'u ndalohet t'u nënshtrohen testeve të College Board në të ardhmen.

Kur të keni mbaruar së lexuari dhe të keni shënuar kutinë në fund të seksionit për të treguar se jeni dakord me këto politika, vazhdoni të lexoni **Privacy Statement (Deklaratën e Politikave)** për të kuptuar se si College Board e vë privatësinë tuaj si prioritet. Kur të arrini në fund të seksionit të **Deklaratës së Privatësisë**, ju lutem ndaloni së lexuari, uleni lapsin dhe shikoni lart nga unë.

Tani do t'ju bëhen disa pyetje për të përcaktuar hyrjen tuaj në Programin National Merit Scholarship Program të zhvilluar nga National Merit Scholarship Corporation. Pastaj, ju do t'i lexoni disa përmbajtje opsionale rreth programeve dhe shërbimeve të College Board. Kur të arrini seksionin me titull **Digital Test Security (Siguria e Testit Digjital)**, ju lutem ndaloni së lexuari dhe shikoni lart nga unë.

Pothuajse kemi mbaruar me *Paper Test Taker Administration Instructions*. Ju lutemi lexoni përkujtuesin rreth rregullave që zbatohen për këtë test. Për të dëshmuar pajtimin tuaj me këto rregulla, shkruani zotimin e sigurisë së testit të dhënë më poshtë listës së rregullave. Kur të keni mbaruar, ju lutem leni poshtë lapsin tuaj dhe shikoni lart.

Ju lutemi rishikoni 4 pjesët e informatave të renditura nën **Confirm Your Info on Your Test Book (Konfirmoni informatat tuaja në librin tuaj të testimit)**, më pas kthehuni në pjesën e pasme të librit tuaj të testimit, pastaj ose konfirmoni që informatat tuaja janë regjistruar me saktësi atje, ose shtoni informatën e saktë tani. Pastaj, mbi emrin tuaj në kopertinë e pasme të librit të testimit, shënoni numrin tuaj të regjistrimit nga bileta juaj e hyrjes. Ky informacion do të ndihmojë College Board të krahasoj librin tuaj të testimit dhe përgjigjet me transkriptin tuaj. Kur të keni mbaruar, ju lutem leni poshtë lapsin tuaj dhe shikoni lart.

Faleminderit për plotësimin e këtij informacioni. Ju lutemi mbyllni broshurën tuaj dhe vendoseni nën bankën tuaj.

4.1 Udhëzimet në kopertinën e pasme

NOTE: Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit. Kur të udhëzoheni, duhet të shkruani në librin tuaj të testit, jo në këtë dokument.

Emri juaj
(Me shkronja të shtypit) _____
MBIEMRI EMRI INICIALI I MESËM

Shkolla _____
NUMRI I SHKOLLËS EMRI I SHKOLLËS NUMRI / EMRI I KLASËS SË TESTIMIT

PSAT/NMSQT

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Mund të punoni në vetëm një modul në të njëjtën kohë.
- Nëse përfundoni një modul para përfundimit të kohës, kontrolloni punën tuaj vetëm në atë modul. Ju NUK mund të kaloni në ndonjë modul tjetër.

SHËNIMI I PËRGJIGJEVE TUAJA

- Sigurohuni që t'u përgjigjeni pyetjeve tuaja siç duhet në këtë libër.
- Rrethoni vetëm një përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

PËRDORIMI I LIBRIT TUAJ TË TESTIT

- Ju mund të përdorni librin e testit për punë të shënimeve/kalkulimeve tuaja.
- Nuk duhet të palosni apo largoni faqe apo pjesë të faqeve nga ky libër, ose të merrni librin nga klasa e testimit.

SIGURIA E TESTIT

Ju jeni të detyruar nga rregullat në vjim për testin e sotëm:

- Ju nuk mund të jepni ose pranoni ndihmë gjatë testit. Ju nuk mund të ndani ose postoni asgjë në lidhje me këtë test.
- Përgjigjet tuaja duhet të jenë tërësisht tuajat. College Board do ti shqyrtojë përgjigjet tuaja.
- Nëse përpiqeni të mashtroni, rezultatet tuaja do të anulohen, zyrat e pranimeve në kolegj mund të njoftohen dhe do të skualifikoheni nga marrja e çdo AP®, SAT®, ose CLEP® provimet.

PAJTIMI I STUDENTIT

Në mënyrë që testi juaj të vlerësohet, duhet të lexoni deklaratën në vijim, të bëni një kontroll pranë “I agree” ("Pajtohem"), dhe nënshkruani emrin tënd.

Unë jam personi që duhet ti nënshtrohet këtij testi. Pajtohem të ndjek rregullat e mësipërme dhe kuptoj se çfarë do të ndodhë nëse i shkel ato.

☐ Pajtohem

Nënshkrimi im:_____

Idetë që përmbajnë pasazhet për këtë test, disa nga të cilat janë nxjerrë ose përshtatur nga materialet e publikuara, nuk i paraqesin domosdo mendimet e College Board.

MOS E HAPNI KËTË LIBËR DERISA KUJDESTARI TË JU THOTË TA BËNI KËTË.

5 # Moduli 1: Lexim dhe Shkrim

Ne do të fillojmë testimin me modulin e parë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Pasi të fillojmë, do të keni ___ minuta për të punuar në Modulin 1. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit, si dhe do t'ju njoftoj kur kanë mbetur edhe 5 minuta.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit. Nëse je gati të ecësh përpara, të lutem lëre lapsin poshtë dhe shiko lart, por mos ec përpara derisa të të them unë.

Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i parë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Fat të mbarë, të gjithë.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

Gjatë Modulit

Kur kanë mbetur edhe 5 minuta, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 1.

Kur koha të mbaroj, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

5.1 Udhëzime për Modulin 1 të Leximit dhe Shkrimit

Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 1 të Leximit dhe Shkrimit.
33 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të të lexuarit dhe të shkruarit. Çdo pyetje përfshin një ose më shumë hyrje, të cilat mund të përfshijnë një tabelë ose grafik. Lexoni me kujdes çdo hyrje dhe pyetje, dhe më pas zgjidhni përgjigjen më të mirë për pyetjen bazuar në hyrjen(t).

Të gjitha pyetjet në këtë seksion janë me zgjedhje të shumëfishta me zgjedhje prej katër përgjigjeve. Çdo pyetje ka një përgjigje të vetme më të mirë.

5.2 Për nxënësit që testohen me Pushime Shtesë ose Kohë të Zgjatur

Ky seksion vlen **vetëm** për nxënësit që testohen me pushime shtesë ose kohë të zgjatur. Kujdestari juaj do ti lexojë vetëm udhëzimet që vlejnë për klasën tuaj të testimit. Nëse këto udhëzime nuk vlejnë për klasën tuaj të testimit, kujdestari juaj do të vazhdojë me Modulin 2.

Nxënësve që testohen me pushime shtesë ose kohë të zgjatur, kujdestari juaj do t'u thotë:

Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë. Do të ndalemi tani për një pushim para modulit të radhës. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos i diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos iu qasni asnjë lloji të pajisjeve elektronike gjatë këtij pushimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Ushqimet e lehta dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për nxënësit që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Nxënësve që testohen me pushime shtesë OSE kohë të zgjatur (por jo pushime të zgjatura), do t'u thotë:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 5 minutave.

Nxënësve që testohen me kohë të zgjatur DHE pushime të zgjatura, kujdestari juaj do t'u thotë:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 10 minutave.

Pushim nga Testimi

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

6 Moduli 2: Lexim dhe Shkrim

Do të vazhdojmë testimin me modulin e dytë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Pasi të fillojmë, do të keni ___ minuta për të punuar në Modulin 2. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit, si dhe do t'ju njoftoj kur kanë mbetur edhe 5 minuta.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit. Nëse je gati të ecësh përpara, të lutem lëre lapsin poshtë dhe shiko lart, por mos ec përpara derisa të të them unë.

Tani, hapni librin tuaj të testit në modulin e dytë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

Gjatë Modulit

Kur kanë mbetur edhe 5 minuta, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 2.

Kur koha të mbaroj, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

6.1 Udhëzime për Modulin 2 të Leximit dhe Shkrimit

Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 2 të Leximit dhe Shkrimit.
33 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të të lexuarit dhe të shkruarit. Çdo pyetje përfshin një ose më shumë hyrje, të cilat mund të përfshijnë një tabelë ose grafik. Lexoni me kujdes çdo hyrje dhe pyetje, dhe më pas zgjidhni përgjigjen më të mirë për pyetjen bazuar në hyrjen(t).

Të gjitha pyetjet në këtë seksion janë me zgjedhje të shumëfishta me zgjedhje prej katër përgjigjeve. Çdo pyetje ka një përgjigje të vetme më të mirë.

7 Ndarja e Seksionit

Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë. Do të ndalemi tani për një pushim përpara se të fillojmë seksionin tjetër. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos i diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos iu qasni asnjë lloji të pajisjeve elektronike gjatë këtij pushimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Ushqimet e lehta dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për nxënësit që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Për nxënësit që testohen me kohë standarde, kujdestari juaj do të thotë:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 10 minutave.

Për nxënësit me pushime të zgjatura ose nxënësit që kualifikohen për një pushim ushqimor, thoni:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 20 minutave.

Pushim nga Testimi

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

8 Moduli 1: Matematikë

Ne do të vazhdojmë testimin me modulin e parë të seksionit të Matematikës. Pasi të fillojmë, do të keni ___ minuta për të punuar në Modulin 1. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit, si dhe do t'ju njoftoj kur kanë mbetur edhe 5 minuta. Mund ta vendosni kalkulatorin në tavolinën tuaj tani.

Mos harroni ti ndiqni këto udhëzime:

- Mbani librin e testit dhe kalkulatorin të shtrirë mbi tavolinën tuaj. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.
- Mos e ndani apo shkëmbeni kalkulatorin tuaj.
- Nëse keni kalkulator rezervë apo bateri, mbani në dysheme nën tavolinën tuaj.
- Nëse kalkulatori juaj nuk funksionin dhe keni bateri ose kalkulator rezervë, ngrijeni dorën. Do të afrohem për të ju ndihmuar. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni testin dhe bëni më të mirën që mundeni.
- Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit. Nëse je gati të ecësh përpara, të lutem lëre lapsin poshtë dhe shiko lart, por mos ec përpara derisa të të them unë.
- Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i parë të seksionit të Matematikës. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

Gjatë Modulit

Kur kanë mbetur edhe 5 minuta, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 1.

Kur koha të mbaroj, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

8.1 Udhëzimet e Modulit 1 të Matematikës

Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 1 të Matematikës.
27 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme matematikore.

Përdorimi i një kalkulatori lejohet për të gjitha pyetjet.

SHËNIME

Përveç nëse tregohet ndryshe:

- Të gjitha variablat dhe shprehjet paraqesin numra realë.
- Shifrat e dhëna vizatohen në shkallë.
- Të gjitha figurat shtrihen në një nivel/rrafsh.
- Domeni i një funksioni të dhënë *f* është grupi i të gjithë numrave realë *x* për të cilët *f*(*x*) është numër real.

REFERENCA



$A = \pi r^2$
$C = 2\pi r$

$A = l\,w$

$A = \frac{1}{2}bh$

$c^2 = a^2 + b^2$

Trekëndëshat e drejtë të veçantë



$V = l\,wh$

$V = \pi r^2 h$

$V = \frac{4}{3}\pi r^3$

$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$

$V = \frac{1}{3}l\,wh$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.
Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π.
Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

Për pyetje me zgjedhje të shumëfishta, zgjidhni çdo detyrë, zgjidhni përgjigjen e saktë nga zgjedhjet e dhëna dhe më pas rrethoni përgjigjen tuaj në këtë libër. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

Për pyetjet e përgjigjeve të prodhuara nga studentët, zgjidhni çdo detyrë dhe shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen në librin e testit siç përshkruhet në vijim.

- Pasi të keni shkruar përgjigjen tuaj, rrethoni atë qartë. Ju nuk do të merrni kredi për asgjë të shkruar jashtë rrethit, ose për ndonjë pyetje me më shumë se një përgjigje të rrethuar.
- Nëse gjeni **më shumë se një përgjigje të saktë**, shkruani dhe rrethoni vetëm një përgjigje.
- Përgjigja juaj mund të jetë deri në 5 karaktere për një **përgjigje** pozitive dhe deri në 6 karaktere (përfshirë shenjën negative) për një **përgjigje** negative, por jo më shumë.
- Nëse përgjigjja juaj është një **thyes** që është shumë e gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkruani ekuivalentin dhjetor.
- Nëse përgjigjja juaj është një **dhjetor** që është shumë i gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkurtoje atë ose rrumbullakoje në shifrën e katërt.

- Nëse përgjigjja juaj është një **numër i përzier** (si p.sh. 3½), shkruajeni atë si një thyesë e parregullt (7/2) ose ekuivalentin e saj dhjetor (3.5).
- Mos përfshini **simbolet** të tilla si një shenjë përqindjeje, presje ose shenjë dollari në përgjigjen tuaj të rrethuar.

8.2 Për nxënësit që testohen me Pushime Shtesë ose Kohë të Zgjatur

Ky seksion vlen **vetëm** për nxënësit që testohen me pushime shtesë ose kohë të zgjatur. Kujdestari juaj do ti lexojë vetëm udhëzimet që vlejnë për klasën tuaj të testimit. Nëse këto udhëzime nuk vlejnë për klasën tuaj të testimit, kujdestari juaj do të vazhdojë me Modulin 2.

Nxënësve që testohen me pushime shtesë ose kohë të zgjatur, kujdestari juaj do t'u thotë:

Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë. Do të ndalemi tani për një pushim para modulit të radhës. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos i diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos iu qasni asnjë lloji të pajisjeve elektronike gjatë këtij pushimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Ushqimet e lehta dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për nxënësit që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Nxënësve që testohen me pushime shtesë OSE kohë të zgjatur (por jo pushime të zgjatura), do t'u thotë:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 5 minutave.

Nxënësve që testohen me kohë të zgjatur DHE pushime të zgjatura, kujdestari juaj do t'u thotë:

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 10 minutave.

Pushim nga Testimi

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

9 # Moduli 2: Matematikë

Ne do të vazhdojmë testimin me modulin e dytë të seksionit të Matematikës. Pasi të fillojmë, do të keni ___ minuta për të punuar në Modulin 2. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit, si dhe do t'ju njoftoj kur kanë mbetur edhe 5 minuta.

Mbani librin e testit dhe kalkulatorin të shtrirë mbi tavolinën tuaj. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit. Nëse je gati të ecësh përpara, të lutem lëre lapsin poshtë dhe shiko lart, por mos ec përpara derisa të të them unë.

Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i dytë të seksionit të Matematikës. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

Gjatë Modulit

Kur kanë mbetur edhe 5 minuta, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 2.

Kur koha të mbaroj, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë. Tani, ju lutem mbyllni librin tuaj të testit dhe lëreni mbi tavolinën tuaj.

9.1 Udhëzimet e Modulit 2 të Matematikës

Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 2 të Matematikës.
27 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme matematikore.

Përdorimi i një kalkulatori lejohet për të gjitha pyetjet.

SHËNIME

Përveç nëse tregohet ndryshe:

- Të gjitha variablat dhe shprehjet paraqesin numra realë.
- Shifrat e dhëna vizatohen në shkallë.
- Të gjitha figurat shtrihen në një nivel/rrafsh.
- Domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA



$A = \pi r^2$
$C = 2\pi r$

$A = l\,w$

$A = \frac{1}{2}bh$

$c^2 = a^2 + b^2$

Trekëndëshat e drejtë të veçantë



$V = l\,wh$

$V = \pi r^2 h$

$V = \frac{4}{3}\pi r^3$

$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$

$V = \frac{1}{3}l\,wh$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π.

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

Për pyetje me zgjedhje të shumëfishta, zgjidhni çdo detyrë, zgjidhni përgjigjen e saktë nga zgjedhjet e dhëna dhe më pas rrethoni përgjigjen tuaj në këtë libër. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

Për pyetjet e përgjigjeve të prodhuara nga studentët, zgjidhni çdo detyrë dhe shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen në librin e testit siç përshkruhet në vijim.

- Pasi të keni shkruar përgjigjen tuaj, rrethoni atë qartë. Ju nuk do të merrni kredi për asgjë të shkruar jashtë rrethit, ose për ndonjë pyetje me më shumë se një përgjigje të rrethuar.
- Nëse gjeni **më shumë se një përgjigje të saktë**, shkruani dhe rrethoni vetëm një përgjigje.
- Përgjigja juaj mund të jetë deri në 5 karaktere për një **përgjigje** pozitive dhe deri në 6 karaktere (përfshirë shenjën negative) për një **përgjigje** negative, por jo më shumë.
- Nëse përgjigjja juaj është një **thyes** që është shumë e gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkruani ekuivalentin dhjetor.
- Nëse përgjigjja juaj është një **dhjetor** që është shumë i gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkurtoje atë ose rrumbullakoje në shifrën e katërt.
- Nëse përgjigjja juaj është një **numër i përzier** (si p.sh. 3½), shkruajeni atë si një thyesë e parregullt (7/2) ose ekuivalentin e saj dhjetor (3.5).
- Mos përfshini **simbolet** të tilla si një shenjë përqindjeje, presje ose shenjë dollari në përgjigjen tuaj të rrethuar.

10 # Lirimi

Para lirimit, kujdestari juaj do të thotë:

Urime! Ju keni përfunduar testin Preliminary SAT/National Merit Scholarship Qualifying Test, ose PSAT/NMSQT. Vet fakti që jeni këtu sot dhe e përfunduat provimin është një arritje e rëndësishme. Ju lutemi, uluni në qetësi derisa unë i mbledh dhe i numëroj materialet tuaja të testimit.

Pasi të numërohen të gjitha materialet, kujdestari juaj do të thotë:

Mbani mend, duke i dorëzuar përgjigjet tuaja, ju pranoni që të mos merrni asnjë pyetje të testit nga klasa e testimit, t'ia jepni askujt ose t'i diskutoni ato me këdo përmes emailit, mesazheve me tekst, në internet ose në ndonjë mënyrë tjetër. Kjo ndihmon që të sigurohet se gjithë nxënësit të kenë një përvojë të drejtë dhe të barabartë të testimit. Nëse keni parë diçka sot që ju brengos, ejani dhe flisni me mua para se të largoheni.

Siç e thashë në fillim të testit, nëse një person shkel ndonjë nga politikat që lidhen me sigurinë e testit, rezultatet e tij do të anulohen dhe ai mund të ndalohet të hyjë në teste të tjera të College Board në të ardhmen.

Ju lutem prisni në ulësen tuaj derisa të ju liroj. Në atë pikë, mund të mblidhni gjërat tuaja personale dhe të afroheni për të marrë çfarëdo që keni dorëzuar para testit. Derisa largoheni, ju lutem keni konsideratë për të tjerët që janë ende duke punuar në klasat tjera. Nëse doni ti dini si ti anuloni rezultatet tuaja, unë mund t'ju ndihmoj para se të largoheni.

Sërish, përgëzime për punën tuaj sot.

Kujdestari juaj do ta marr këtë broshurë nga ju para se ju të largoheni.